



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 214/3 prot.

Tiranë, më 04.06.2018

VENDIM

Nr. 56, datë 04.06.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 6, DATË 31.01.2017, NË
INSTITUCIONIN E INSTITUTIT TË SIGURISË USHQIMORE DHE
VETERINARISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 6, datë 31.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 138, datë 30.12.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur të fillojë mbikëqyrjen e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 6, datë 31.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, në të cilin është vendosur:

“2. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, njësia përgjegjëse (DAP), në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe nenit 111, 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me rastet e deklarimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të mosrespektimit të afatit kohor të punësimit në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulohet aktin administrativ nr. 1198/40, datë 30.10.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen *****, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.*
- Të anulohet aktin administrativ nr. 1198/9, datë 30.10.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen *****, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.*
- Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës për punonjëset e mësipërme, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.*
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.*
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).*
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës dhe të njoftohet për këtë vendim njësia përgjegjëse (DAP). Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).*

3. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të

tregojnë kujdes, për të gjitha procedurat që kanë lidhje me administrimin e shërbimit civil, të cilat janë kryer në mënyrë elektronike e konkretisht, në këtë rast për formularët e përshkrimit të punës, t'i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar; ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010, "Për dokumentin elektronik" si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, "Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike".

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesuar që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej t'i depozitohet ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike, ashtu si është arsyetuar në raport.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes."

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë me kalimin e afatit të lënë në pikën 4 të vendimit paralajmërues, me shkresën nr. 1042 prot., datë 07.03.2017, "Kthim përgjigje", ka informuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 6, datë 31.01.2017. Pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur kësaj shkrese, Komisioneri ka përmbyllur procesin e verifikimit me Vendimin Nr. 152, datë 11.07.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 6, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë", në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", në të cilin është konstatuar zbatimi pjesërisht i rekomandimeve dhe verifikimi i mëtejshëm i pikës 2 të këtij vendimi.

Bazuar në Autorizimin nr. 214 prot., datë 31.01.2018, të miratuar nga Komisioneri, u krye verifikimi i mëtejshëm i Vendimit Nr. 6, datë 31.01.2017, si dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për periudhën Tetor 2016 - Janar 2018.

Nga shqyrtimi i materialeve shkresore, të vëna në dispozicion të grupit të punës, konstatohet se:

Në pikën 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse (DAP), që në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të anulohet aktet administrative të deklarimit të statusit të punësimit duke e ndryshuar pozicionimin e tyre në raport me shërbimin civil nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjëset ***** dhe *****, kohëzgjatja e periudhës së punësimit të cilave në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil ishte më pak se 1 vit.

Në Vendimin Nr. 152, datë 11.07.2017, të Komisionerit, është konstatuar se të dyja këto punonjëse kishin filluar trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s dhe nga ana e eprorit direkt ishte kryer vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës.

Nga verifikimi i akteve që materializojnë zbatimin e këtij rekomandimi konstatohet se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit të mbikëqyrur, me shkresën nr. 609/1 prot., datë 07.07.2017, i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike, praktikën e konfirmimit si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës për nëpunëset e sipërcituara (*vlerësimet e rezultateve në punë, mendimet me shkrim nga nëpunësit civilë më të vjetër, rezultatet e testimit të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA dhe vendimet e konfirmimit të eprorit direkt në përfundim të periudhës së provës*). Në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 13, të Kreut VI, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, njësia përgjegjëse (DAP) ka nxjerrë aktet e deklarimit si më poshtë:

1. Aktin nr. 4535/2 prot., datë 20.09.2017, për deklarimin si nëpunës civil të ***** në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Vlerësimit të Cilësisë së Ushqimeve, në Departamentin e Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë.
2. Aktin nr. 4535/3 prot., datë 20.09.2017, për deklarimin si nëpunës civil të ***** në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Toksikologjisë dhe Mbetjeve, në Departamentin e Toksikologjisë dhe Monitorimit të Mbetjeve.

Në analizë të sa u parashtrua më sipër, konkludohet se, edhe pse, formalisht, nga njësia përgjegjëse nuk është kryer anulimi i akteve të deklarimit të statusit të punësimit, sikundër ishte lënë detyrë nga ana e Komisionerit, me veprime konkludente, njësia përgjegjëse e ka kryer këtë detyrë, duke qenë se këto nëpunëse iu nënshtruan të gjitha procedurave që parashikon ligji dhe aktet nënligjore për periudhën e provës.

Nga verifikimi i mënyrës së emërimeve në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për periudhën Tetor 2016 – Janar 2018, u konstatuan **3 (tre)** raste emërimi

në pozicione pune të shërbimit civil, me akt emërimi të përkohshëm apo kontratë punësimi, të nxjerra në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit në këtë institucion.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar nga grupi i punës, vërej se, titullari i institucionit, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, ka shfuqizuar aktet e emërimit absolutisht të pavlefshme, duke ndërprerë njëkohësisht marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për tre punonjësit si më poshtë (vërtetuar kjo edhe nga listëpagesa e muajit Shkurt 2018).

Në përfundim, konkludoj se:

- Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 6, datë 31.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.
- Gjatë periudhës objekt verifikimi, situata e paligjshmërisë për 3 (tre) rastet e emërimit të përkohshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është rregulluar. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të tregojë kujdes që në të ardhmen të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rregullave ligjore për të garantuar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, duke garantuar të drejtat e nëpunësve civilë të cilët ushtrojnë detyrën në këtë institucion, nëpërmjet administrimit të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 6, datë 31.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
3. Konstatimin e rregullimit të paligjshmërisë për **3** (tre) rastet e emërimit të dala në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha